



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_995_06_13**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 20.08.2013.

në seancën e mbajtur më datë 06 shtator 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZHET** ankesa e parashtruesit të ankesës R.L. (shifra e konsumatorit: DPR - 90045905) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_995_07_13 i datës 17.07.2013.

Arsyetim

Departamenti i faturimit në KEK me datë 05.03.2013 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për muajin shkurt 2013 me shpenzim prej 5645 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 442.51€. Pas arritjes së kësaj fature konsumatori me datë 07.03.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturën shkurt 2013 për shkak të leximit jo të saktë/korrektë.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse me datë 13.03.2013 ka inspektuar pikën matëse konsumatorit me shifër DPR – 90045905 dhe gjatë inspektimit ka evidentuar gjendjen reale të shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 12438533, e cila në momentin e inspektimit ka qenë: TL=30909 kW (tarifa e lartë) dhe TU= 54292 kW (tarifa e ulët).

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 22.03.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e bazuar në procesverbalin nr. 2437840 të datës 13.03.2013 dhe listat e leximit të KEK-ut. Pas kësaj përgjigje konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjen e KEK-ut.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 17.07.2013 ka nxjerr vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit, por që duke kërkuar nga KKDFE që për faturën e muajit shkurt 2013 me shpenzim prej 5645 kWh apo llogaritur në vlerë financiare prej 442.51€, t'ia mundësojë konsumatorit me shifër DPR –90045905 një marrëveshje për pagesë për 4 muaj.



Pas marrjes se vendimit të DMK-së, më datë 20.08.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_995_07_13 të datës 17.07.2013. Konsumatori në ankesë thekson se nuk pajtohet me vendimin e DMK-së pasi që nuk ka shpenzuar energjinë për muajt e cekur. Konsumatori thekson se duhet të krijohet një komision për të analizuar shpenzimin e tij dhe se sipas konsumatorit shpenzimi për muajin shkurt 2013 është për tre muaj ndërsa për muajt tjerë janë paguar faturat.

Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur me datë 06.09.2013 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e konsumatorit të theksuar në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se për muajin shkurt 2013 Departamenti i faturimit në KEK me datë 05.03.2013 e ka faturuar konsumatorin me shpenzim mujor prej 5645 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 442.51€. Po ashtu është analizuar edhe procesverbali i inspektimit të KEK-ut nr. 2437840 e datës 13.03.2013 dhe është vërejtur se me rastin e inspektimit të pikës matëse nga punëtorët e autorizuar të KEK-ut gjendja e njehsorit elektrik nr. 12438533 ka qenë: TL=30909 kW (tarifa e lartë) dhe TU= 54292 kW (tarifa e ulët). Gjendja e evidentuar në muajin mars 2013 sipas rrjedhës së energjisë elektrike ka qenë TL= 31375 kW dhe TU= 55037 kW përputhet me gjendjen e evidentuar në procesverbalin e kontrollës së KEK-ut nr. 2437840 të datës 13.03.2013 e cila ka qenë TL=30909 kW dhe TU= 54292 kW.

Janë analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut prej periudhës 09/2012 e deri më 04/2013 dhe ka vërejtur se në listat e leximit prej periudhës 09/2012 – 11/2012 lexuesi i KEK-ut ka evidentuar se njehsori elektrik është në rregull dhe se ka marrë edhe gjendjen e shpenzimit për çdo muaj, në muajin 12/2012 lexuesi ka evidentuar se nuk ka çasje por ka harxhim, në listën e leximit të periudhës 01/2013 është evidentuar se njehsori elektrik është në rregull dhe se ka marrë gjendjen e shpenzimit, në listën e leximit të periudhës 02/2013 është evidentuar se është pa harxhim, si dhe në listën e leximit të periudhës 03/2013 – 04/2013 lexuesi ka evidentuar se njehsori është në rregull dhe ka marrë gjendjen e shpenzimit.

Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se ka mospërputhje mes faturave të energjisë elektrike dhe rrjedhës së energjisë elektrike të periudhave 01/2013 dhe 02/2013, ngase gjendja e shpenzimit të evidentuar në listat e leximit nuk është e njëjtë me ato të faturuar nga Departamenti i Faturimit në KEK, madje edhe fatura e muajit 12/2012 është faturuar me vlerësim e jo me shpenzim.

Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike dhe ka vërejtur se nga periudha 12/2012 – 03/2013 nuk ka pasur lexim dhe faturim të saktë dhe se për këtë periudhë të faturimit janë grumbulluar 10,854 kWh dhe se nëse këta kilovat i ndajmë proporcionalisht me këta muaj del se mesatarisht në këtë shifër janë shpenzuar për muaj nga 2713.5 kWh, e që është pothuajse e njëjtë me shpenzimin e muajve të njëjtë të viteve të mëhershme. Po ashtu nëse këtë shpenzim e shpërndajmë proporcionalisht për periudhën 12/2012 – 03/2013 vërehet se nuk ka elemente të korigjimit që duhet t'i bëhet konsumatorit.

Sipas analizave të bëra shpenzimit të energjisë elektrike të shifrës DPR – 90045905 vërehet se në sezonën dimërore prej periudhës 10/2012 – 03/2013 është 2240 kWh, për periudhën 10/2011 – 03/2012 është 1827 kWh/muaj; për periudhën 10/2010 – 03/2011 është 1959 kWh/muaj; për periudhës 10/2009 – 03/2013 është 2080 kWh/muaj.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës, në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.



Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 06.09.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_995_07_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar